



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4692/3 Prot.

Tiranë, më 23/12/2025

URDHËR

NR. 733, DATË 23/12/2025

**“PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT DHE TË ZËVENDËS ANËTARIT
TË KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 73, pika 1 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat” si dhe Urdhrit nr. 197, datë 26.06.2020 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë dhe zëvendës anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë”;

KONSTATOJ:

Në vijim të kërkesës për shprehje interesi për t’u zgjedhur anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit të njërit prej anëtarëve i cili zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë, të publikuar më datë 11.06.2025 në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, janë paraqitur kandidaturat të cilat kanë shprehur interes sipas parashikimeve të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”.

Në zbatim të urdhrit Nr. 350, datë 02.06.2025 të Ministrit të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidatëve për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë”, i ndryshuar, është vijuar me trajtimin e kandidaturave të paraqitura dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Në përfundim të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore, të kandidaturave të paraqitura, ka rezultuar se, dokumentacioni i paraqitur nga znj. Alketa Elezi dhe znj. Ersida Teliti janë dërguar brenda afatit ligjor të përcaktuar në shprehjen e interesit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton, se znj. Alketa Elezi dhe znj. Ersida Teliti kanë përvojë

të gjatë dhe të mirëfilltë në fushën juridike. Konkretisht, spikat përvoja e punës së tyre si pedagoge në universitet.

Për sa më sipër, bazuar në eksperiencën e gjatë dhe të provuar profesionale, në titujt dhe gradat shkëncore, që zotërojnë, rezulton se, znj. Alketa Elezi dhe znj. Ersida Teliti plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” dhe Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 350, datë 02.06.2025 të Ministrit të Drejtësisë, i ndryshuar, ndaj në këto kushte,

URDHËROJ:

1. Zgjedhjen e znj. Alketa Elezi, si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.
2. Zgjedhjen e znj. Ersida Teliti, si zëvendës anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.
3. Mandati i znj. Alketa Elezi dhe i znj. Ersida Teliti, si anëtar dhe zëvendës anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, është mandat katërvjeçarë, pa të drejtë rizgjedhje të menjëhershme.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri, znj. Alketa Elezi, znj. Ersida Teliti, Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat, si dhe Shkollës së Magjistraturës.
5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

BESFORT LAMALLARI

